



Ngjyra e re e parasë

Më të sigurtë. Më të mençur. Më të mbrojtur

www.moneyfactory.com/newmoney



Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës po nxjerr para me dizajne të reja dhe me karakteristika sigurie, duke filluar me kartmonedhën 20 dollarëshe, e cila u lëshua në qarkullim në fund të vitit 2003. Kartmonedhë 50-dollarëshe do të lëshohet në përdorim kah fundi i vitit 2004, ndërsa më vonë edhe kartmonedha 100 dollarëshe.

Paraja e ridizajnuar është më e sigurtë, më e mençur dhe më e mbrojtur: më e sigurtë sepse është vështirë të fallsifikohet dhe lehtë të kontrollohet; më e mençur sepse qëndron më lart sesa fallsifikuesit të cilët lehtë i mësojnë teknikat e reja, dhe më e sigurtë për të mbrojtur integritetin e monedhës amerikane.

Ndryshimi më i dukshëm i dizajnit të ri është futja e ngjyrës së brendshme që e bën më të vështirë fallsifikimin për fallsifikuesit e mundshëm sepse shton kompleksitetin e kartmonedhës. Ngjyra do ta bëjë gjithashtu më të lehtë dallimin midis denominimeve, sepse do të përdoren ngjyra të ndryshme të brendshme për secilin denominim.

Sidoqoftë, përveç shtimit të ngjyrës, kartmonedha e re ruan madhësinë e dallueshme, pamjen dhe ndijimin e monedhës tradicionale amerikane - monedha më e njohur dhe më e qarkulluar.

Kartmonedha e re 50-dollarëshe është e dyta e cila lëshohet në qarkullim si pjesë e Serisë 2004, dhe ajo përfshin jo vetëm ndryshime të ngjyrës por edhe simbole historike amerikane. Kartmonedhë e re 20-dollarëshe u lëshua në përdorim në vitin 2003 me ngjyrë të gjelbër, pjeshke dhe të kaltër si dhe motive të shqiponjës amerikane. Kartmonedha e re 50-dollarëshe, e cila do të lëshohet në qarkullim në fund të vitit 2004, përfshin nuanca të ngjyrës të kaltër dhe të kuqe si dhe motiv flamuri që valon dhe ylli ngjyrë të kaltër në të argjendtë. Pas kësaj do të lëshohet kartmonedha e re 100 dollarëshe. Shqyrtohet mundësia për ri-dizajnim të kartmonedhave 5-dollarëshe dhe 10-dollarëshe mirëpo ridizajnimi i kartmonedhave 2 dollarëshe dhe 1 dollarëshe nuk është në plan.

Sistemi i rezervave federale dhe Departamenti i thesarit janë të angazhuar të vazhdojnë përmirësimet në dizajnin të monedhës me qëllim që të mbrohet ekonomia dhe paratë tuaja të fituara me vështirësi. Për tu siguruar për këtë, ne presim të fusim dizajnet e reja të kartmonedhave cdo 7 deri në 10 vjet.

Një kalim i butë

Ndërkohë që pamja e kartmonedhës do të kalojë përmes ndryshimeve të brendshme, të gjitha kartmonedhat, të reja apo të vjetra, do të respektohen në vlerën e tyre të plotë. Nuk do të ketë mbledhje apo zhvlerësim të ndonjë kartmonedhe amerikane. Shtetet e Bashkuara nuk e kanë zhvlerësuar kurrë monedhën e tyre dhe nuk do ta bëjnë këtë. Ndërkohë që kartmonedhat e reja futen në qarkullim, kartmonedhat e vjetra do të arkivohen nga Sistemi i rezervave federale, pasi kthehen përmes sistemit bankar. Kjo do të thotë se nuk ka ndonjë afat kohor apo kërkesë për shkëmbimin e serisë së mëparshme me seritë e reja.

Për më shumë informacion lidhur me dizajnin e kartmonedhës së re, vizitoni:
www.moneyfactory.com/newmoney

Karakteristikat e sigurisë

Dizajni i ri për kartmonedhën 50 dollarëshe përmban tri prej karakteristikave më të rëndësishme të sigurisë që u futën për herë të parë në vitet 90' dhe janë të lehta për tu kontrolluar: një vulë uji, filli i sigurisë dhe boja që ndryshon ngjyrë.

Filli i sigurisë

Mbajeni kartmonedhën drejt dritës dhe kontrolloni nëse e ka fillin e sigurisë, ose rripin plastik, që është qëndisur në letër dhe shkon vertikalisht lart në njërin anë të kartmonedhës. Nëse sheh nga afër, fjalët “USA 50” dhe një flamur i vogël janë të dukshëm nëpër fije nga të dyja anët e monedhës. Ky fill shkon në të gjelbër kur mbahet nën dritën ultraviolet.

Boja që ndryshon ngjyrë

Shikoni numrin 520” në anën e djathtë poshtë në faqen kryesore të kartmonedhës. Kur e lëviz kartmonedhën lart-poshtë, ngjyra e bojës ndryshon nga bakër në të gjelbër.

Vula e ujit

Mbajeni kartmonedhën lart në dritë dhe shikoni vulën e ujit, një imazh i zbehtë, i ngjashëm me portretin e presidentit Ulysses S. Grant. Vula e ujit është pjesë e vetë letrës dhe mund të shihet nga të dyja anët e kartmonedhës.

Karakteristika të reja

Ngjyra

Ndryshimi më i dukshëm në dizajnimin e ri të kartmonedhës është shtimi i ngjyrave të brendshme të kaltër dhe të kuqe në të dyja anët e kartmonedhës. Poashtu 50-she të vogla me ngjyrë të verdhë janë të shtypura në anën e pasme të kartmonedhës.

Simbolet e lirisë

Simbole të reja të lirisë, janë dizajnuar në anën kryesore të kartmonedhës. Yjet dhe vijat tradicionale të flamurit të SHBA janë të printuara me ngjyrë të kaltër dhe të kuqe pas portretit të Presidentit Grant. Një fushë me yje të kaltra është e vendosur në pjesën e majtë të portretit, dhe tre vija të kuqe në pjesën e djathtë të portretit. Një yll i vogël me ngjyrë argjendi në të kaltër është i vendosur në anën e djathtë, poshtë, të portretit. Simbolet e lirisë do të ndryshojnë për secilin denominim.

Portreti dhe Vinjeta

Kufijtë ovalë dhe linjat e holla që rrethojnë portretin e Presidentit Ulysses S. Grant përballë dhe vinjetën e Kapitollit në anën e pasme, janë hequr. Portreti është lëvizur lart dhe shpatullat janë zgjeruar deri në kufijtë e kartmonedhës. Hollësi të tjera i janë shtuar brendësisë së vinjetës.

Karakteristika të tjera

Përvec tri karakteristikave përparësore, kartmonedha e re 50 dollarëshe mban gjithashtu karakteristika të tjera ekzistuese.

Mikro-printimi

Meqë ato janë kaq të vogla, fjalët e mikro-printuara është vështirë t'i riprintosh. Kartmonedha e ridizajnuar ka si karakteristikë të saj mikro-printimin në faqen kryesore të kartmonedhës në tre

zona të reja: fjalët “FIFTY”, “USA”, dhe “50” janë printuar në dy prej yjeve të kaltra në anën e majtë të portretit, fjala “FIFTY” përsëritet brenda dy kufijve të kartmonedhës, dhe fjalët “THE UNITED STATES OF AMERICA” shfaqen në jakën e Presidentit Grant, nën mjekërr.

Karakteristika të vizionit të ulët

Numërimi i madh “50” në qoshen poshtë në të djathtë, në anën e pasme të kartmonedhës lexohet lehtë.

Letra

Letra për kartmonedhat është një e katërta sintetike dhe tri të katërtat pambuk dhe përmban fibra të kuq dhe blu.

Treguesit e Rezervave Federale

Një vulë universale në anën e majtë të portretit përfaqëson gjithë Sistemin e rezervave federale. Një shkronjë dhe një numër poshtë numrit serial në të majtë, identifikon nënshkrimin Banka e rezervave federale.

Numrat serialë

Kombinimi unik i 11 numrave dhe shkronjave shfaqet dy herë në faqen kryesore të kartmonedhës. Në kartmonedhën e re 50 dollarëshe numri serial në të majtë është lëvizur në të djathtë, në krahasim me dizajnet e mëparshme.

Udhëzuesi i xhepit

Edhe kartmonedhat e reja, edhe të vjetrat do të vazhdojnë të jenë para e ligjshme me vlerë të plotë. Shtetet e Bashkuara nuk e kanë zhvlerësuar ndonjëherë monedhën e tyre dhe nuk do ta bëjnë këtë.

Pasojnë imazhet e tri kartmonedhave 50 dollarëshe amerikane që janë ende në qarkullim.

Kartmonedhat para vitit 1996.

Seritë e kartmonedhave të vitit 1996.

Seritë e kartmonedhave të vitit 2004.